



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta/Ministry of Culture, Youth & Sports

Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale/ Agjencia za Upravljanje Spomenika i Memorijalnih Kompleksa/ Agency for the Management of Monuments and Memorial Complexes

DATË/A:	29.11.2024
REFERNCË:	153.11.24
PËR	Z. Hajrulla Çeku/ Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit
CC	Z. Bislim Bislimi / Sekretar i Përgjithshëm i MKRS Njësisë Përgjegjëse / MKRS
NGA	Z. Imer Hakaj/ Drejtor Ekzekutiv i AMMKM-së
TEMA	Plani i Performancës për vitin 2025



Të nderuar,

Bazuar në Rregulloren (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, neni 6, Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, ka përgatitur Planin e Performancës për vitin 2025.

Kësaj shkrese do t'ia bashkangjesim Planin e Performancës për vitin 2025, pjesën tabelare dhe shtojcat.

Me respekt!



AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E
MONUMENTEVE DHE KOMPLEKSEVE MEMORIALE

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /Ministry of Culture, Youth & Sports
Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale
*Agencija za Upravljanje Spomenika i Memorijalnih Kompleksa/ Agency for the Management
of Monuments and Memorial Complexes*

PLANI I PERFORMANCËS

2025

**AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E MONUMENTEVE DHE
KOMPLEKSEVE MEMORIALE**

Prishtinë, 2024

Plani i Performancës 2025

Në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (tutje AMMKM) të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale është institucioni përgjegjes për projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare.

Me dispozitat e nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës është përcaktuar se:

“Agjencia është përgjegjëse për menaxhimin e komplekseve memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit si Zona me interes të veçantë kombëtarë dhe më karakter historik” dhe

“Agjencia është përgjegjëse për projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare”.

Në kuadër të dispozitave të Ligjit nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, më saktësisht me dispozitat e nenit 2 është përcaktuar që me kompetencën e administrimit nënkupton *“Qeverisje, drejtim dhe organizim i punëve në një fushë duke u bazuar në rregulla dhe ligje përkatëse”* si dhe me kompetencën për menaxhimin nënkupton *kompetencën e Agjencisë për të ndërmarr*

të gjitha aktivitetet e koordinuara për të udhëhequr, administruar dhe kontrolluar Komplekset dhe Memorialët.

AMMKM ka hartuar Planin e Performancës për vitin 2025 duke u bazuar në Strategjinë e Qeverisë së Kosovës 2024-2026 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 12/2023 Mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në Kuadër të Administratës Shtetërore, si dhe duke u bazuar në buxhetin, burimet njerëzore e teknike, që i ka në dispozicion për vitin 2025.

AMMKM në Planin e Performancës për vitin 2025 i ka të përmbledhur pesë objektiva:

- 1) Ndërtimi i monumenteve dhe komplekseve memoriale.**
- 2) Zgjerimi i rrjetit të mirëmbajtjes së Komplekseve Memoriale.**
- 3) Shënjizimi i objekteve që i kanë shërbyer UÇK-së dhe memorialeve të AMMKM-së.**
- 4) Digjitalizimi i Komplekseve dhe Memorialeve të AMMKM-së.**
- 5) Finalizimi i infrastrukturës ligjore për AMMKM-në.**

1) Ndërtimi i Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale

Në vitin 2025, do të ndërtohen dhe restaurohen disa komplekse memoriale në tërë territorin e Kosovës, duke përfshirë projekte në vazhdimësi dhe projekte të reja. Disa nga projektet e planifikuara që janë në vazhdimësi përfshijnë dhjetë komplekse memoriale, gjashtë memoriale, një shtatore, një lapidar, një park, dy shtabe, dy varreza të dëshmorëve dhe një kullë. Përveç këtyre, do të realizohen konservime, restaurime dhe intervenime emergjente në tërë Kosovën, si dhe pllakat informuese dhe një monument-obelisk. Një projekt i ri për vitin 2025 është renovimi i varrezave të dëshmorëve në rajonet e Prishtinës, Mitrovicës, Gjilanit, Ferizajt, Prizrenit, Pejës dhe Gjakovës. Ky planifikim ka një buxhet planifikues prej 6,310,000.00€, që është miratuar nga MKRS.

1.1) Shpronësimi i Pronave.

Me qëllimin që të ndërtohen Komplexet dhe Memorialet, për të evituar problemet pronësore, një nga nën objektivat e AMMKM-së është shpronësimi i pronave.

Sipas Ligjit Nr.03/L-139 dhe plotësim ndryshimit të Ligjit Nr. 03/L-205, AMMKM si organ kërkues i shpronësimit jemi të obliguar të bashkëpunojmë me MMPHI si Organ Shpronësues dhe të zhvillohen procedurat deri në nxjerrjen e vendimit final.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ MF – Nr. 04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve, parasheh buxhetimin e projekteve kapitale ku pjesë e kostos së projektit janë edhe shpenzimet e shpronësimit.

Për vitin 2025 pritet të procedojmë për shpronësim në DSH – MMPHI, disa Komplekse Memoriale për të cilat janë rishikuar - plotësuar me dokumente dhe me të dhënat të reja nga terreni. Tabela me pronat për shpronësim për vitin 2025, i bashkangjiten si shtojcë e veçantë e Planit të Performancës.

2) Zgjerimi i Rrjetit të Mirëmbajtjes së Komplekseve Memoriale

Për vitin 2025, është parashikuar një investim i rëndësishëm për mirëmbajtjen e komplekseve memoriale. Buxheti i parashikuar për projektet në vazhdimësi është 387,000.00€, që do të përdoren për mirëmbajtjen e dymbëdhjetë komplekseve memoriale, njëmbëdhjetë memorialeve, dy lapidarëve, katër varrezave të dëshmorëve dhe martirëve, si dhe për parkun memorial, kullën dhe monumentet. Për projektet e reja të mirëmbajtjes, që janë të planifikuara për vitin 2025, do të alokohen 300,000.00€. Parashihen për mirëmbajtjen e gjashtë komplekseve memoriale, shtatë memorialeve, shtatoreve, shtatë varrezave të dëshmorëve dhe martirëve, si dhe një lapidari dhe parkut memorial. Për vitin 2025, sipas Qarkores Buxhetore 2025/02 dhe kufijve buxhetor të aprovuar nga MFPT dhe MKRS të aprovuar në Qeveri është ndarë buxhet prej 646,648.00€ për mallra e shërbime,

ku përfshihet kostoja për mirëmbajtje të komplekseve memoriale dhe obligimet e tjera kontraktuale të AMMKM-së. Buxheti i ndarë për vitin 2025 nuk do të arrij të sigurojë mjetet e mjaftueshme për ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së komplekseve.

3) Shënjëzimi i objekteve që i kanë shërbyer UÇK-së dhe memorialeve të AMMKM-së

Për vitin 2025 AMMKM ka në projekt shënjëzimin e objekteve të luftës. Ky projekt ka vlerë 159,170.00 euro dhe përfshin 3 lloje të shënjëzimit: 1. Shënjëzimin e memorialeve dhe objekteve tjera të luftës përmes pllakave informuese (të planifikuara 51 copë); 2. Pllakat simbolike për të zhdukurit (të planifikuara 40 copë) dhe 3. Gurëve simbolik për shënjëzimin e vendit të rënies së dëshmorëve (të planifikuara 57 copë).

4) Digjitalizimi i Komplekseve dhe Memorialeve të AMMKM-së

Kjo objektiv ka për qëllim avancimin e teknologjisë për të siguruar ruajtjen, menaxhimin dhe aksesin më të lehtë të informacionit në lidhje me komplekset memoriale. Planifikimi përfshin një buxhet total prej 100,000.00€, i cili do të mundësojë digjitalizimin e këtyre komplekseve: Kompleksi Memorial "Adem Jashari", Kompleksi Memorial "Zahir Pajaziti" në Orllan-Podujevë, Kompleksi Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Vrellë-Istog, Parku Memorial "Bllaca '99", duke krijuar mundësi për të ruajtur informacionet historike dhe për të përmirësuar vizitueshmërinë.

5) Finalizimi i Infrastrukturës Ligjore për AMMKM-në

Është me rëndësi aprovimi i Rregullorës së Brendshme për funksionalizimin e plotë të AMMKM-së dhe zbatimi i Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Me kërkesë të Drejtësisë Tranzicionale në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe grupit punues ndërmintor për drejtësi tranzicionale, është kërkuar hartimi i disa akteve nënligjore, përfshirë hartimin e bazës ligjore për vlerësimin dhe kategorizimin e memorialeve, si dhe krijimin e simboleve përkujtimore për viktimat.

Plani i detajuar është paraqitur në pjesën tabelare në vazhdim, ku përveç objektivave janë paraqitur edhe treguesit, vlera bazë, alokimi financiar, afatet kohore të realizimit të objektivave si dhe tri shtojca me të dhëna më të hollësisshme të projekteve kapitale.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /Ministry of Culture, Youth & Sports
Ajencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale
Agencija za Upravljanje Spomenika i Memorijalnih Kompleksa
Agency for the Management of Monuments and Memorial Complexes

Projekt-Plani për Performancën e Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për vitin 2025						
Data:		29.11.2024				
AGJENCIA		Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale				
MINISTRIA PËRGJEGJËSE		Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit				
Misioni i Agjencisë		Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale misionin e saj e ka të përcaktuar në projektimin, ndërtimin dhe menaxhimin e monumenteve dhe komplekseve memoriale me qëllim të promovimit dhe memorizimit të së kaluarës sonë të lavdishme.				
Objektivat	Treguesi(t)	Vlera bazë	Vlera e synuar	Rezultatet (Autputet)	Alokimi financiar	Referenca ndaj dokumenteve strategjike/politik e
1. Ndërtimi i monumenteve dhe komplekseve memoriale.	iPër vitin 2025 do të ndërtohen këto Memoriale; 1.1. Projekte në vazhdimësi - Dhjetë Komplekse memoriale; - Gjashtë Memoriale; - Një Shtatore; - Një Lapidar; - Një park; - Dy Shtabe;	6,310,000.00€		1. Projektet për vitin 2024 në vazhdimësi do të përfundojnë deri në tremujorin e tretë të vitit 2025. 2. Projektet e reja për vitin 2025 afati i përfundimit është tremujorin e katërt të vitit 2025.	6,310,000.00€ planifikimi buxhetor me kufij të përcaktuar nga MKRS sipas Qarkores së dytë buxhetore	

	- Dy Varreza të dëshmorëve; - Një kullë; - Konservime dhe restaurime në tërë territorin e Kosovës - Pllakat Informuese; - Një Monument-Obelisk - Projekti për Intervenime Emergjente në Komplekse, Memoriale, Varreza të dëshmorëve dhe martirëve në tërë territorin e Kosovës				2025/02.	
	1.2. Projekte të reja në vitin 2025 - Renovimi i Varrezave të dëshmorëve në rajonin e Prishtinës, Mitrovicës, Gjilanit, Ferizajit, Prizrenit, Pejë, Gjakovës. Shojca 1. Dhe 3.					
2. Zgjerimi i Mirëmbajtjes së kompleksve memoriale.	Mirëmbajtjet për 2025 1. Mirëmbajtjet për 2025 vazhdimësi, - Dhjetë Komplekse Memoriale; - Trembëdhjetë Memoriale; - Tre Lapidar; - Pesë Varreza të dëshmorëve dhe martirëve; 2. Mirëmbajtje të reja për vitin 2025, - Katër Komplekse memoriale; - Shtatë Memoriale;	Totali i vlerës për projektet në vazhdimësi 387,000.00 euro Totali i vlerës për projektet e reja 330,000.00		Mirëmbajtja e Komplekseve Memoriale për vitin 2025 . 1. Mirëmbajtja e Komplekseve Memoriale , lapidarëve dhe varreza deri në vitin 2025-2026-2027 2. Mirëmbajtje të reja;	646,648.00 planifikimi buxhetor me kufij të përcaktuar nga MKRS sipas Qarkores së dytë buxhetore 2025/02.	

	- Shtatoreve - Pesë Varreza të dëshmorëve dhe martirëve; - Një lapidar Shiroja 2				
3. Shënjtërimi i objekteve që i kanë shërbyer UÇK-së dhe 3.1 Vendosija e pllakave për të memorialeve pagjeturit të AMMKM-3.2 Shënjtërimi i vendit të rënies të së.	Vendosija e shenjave në objekte të luftës dhe Komplekse Memoriale	159,170.00€		Vendosija e pllakave informuse. Vendosija e tekstit në pllakë dhe vendosja e pllakave në Komplekse dhe Memoriale	
3.3 Vendosija e pllakave Informuese			- Në tremujorin e dytë vendosen 20 pllaka informuese në shënjinin e objekteve të luftës dhe komplekse memoriale; 10 Pllaka simbolike per te zhdukurit; 20 gure simbolik per vendin e renies se deshmorëve.	74,600.00€	
			- Në tremujorin e tretë vendosen 20 pllaka informuese në shënjinin e objekteve të luftës dhe komplekse memoriale; 10 pllaka simbolike per te zhdukurit dhe 25 gure simbolik per vendin e renies se deshmorëve.	41,820.00€	
			- Në tremujorin e katërt vendosen 11 pllaka informuese në shënjinin e objekteve të luftës dhe komplekse memoriale; 20 pllaka simbolike per te zhdukurit dhe 12	51- Shënjtërimi i objekteve të luftës dhe komplekse	

				gure simbolik per vendin e renies se deshmoreve.	memoriale	
4. Digitalizimi i komplekseve dhe memorialeve të AMMKM-së.	- Digitalizimi i Kompleksit Memorial "Adem Jashari"; - Digitalizimi i Kompleksit Memorial "Zahir Pajaziti" Orllan-Podujevë; - Digitalizimi i Kompleksit Memorial "Dëshmorët e Kombit" Vrellë-Istog; - Digitalizimi i Parkut Memorial Bllaca '99	100,000.00€		- Kompleksi Memoria "Adem Jashari" i digitalizuar; - Kompleksi Memorial "Zahir Pajaziti" Orllan-Podujevë i digitalizuar; - Kompleksi Memorial "Dëshmorët e Kombit" Vrellë-Istog i digitalizuar - Kompleksi Memorial "Bllaca '99"-i digitalizuar.	100,000.00€	
5. Finalizimi i infrastrukturës ligjore për AMMKM-në.	Hartimi i akteve nënligjore si: 5.1. Aprovimi nga MKRS i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale; 5.2. Hartimi i Rregullores për miratimin e projekteve dhe kërkesave të tjera; 5.3. Hartimi i Rregullores për të hyrat në Komplekset Memoriale; 5.4. Finalizimi i përkrahimit të vendeve të punës dhe sistematizimi sipas legjislacionit të ri; 5.5. Hartimi i bazës ligjore për vlerësimin dhe kategorizimin e	6,000.00€ (tre mijë euro)		Finalizimi dhe miratimi i akteve si: 5.1. Rregullorja e miratuar; 5.2. Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale-e miratuar në tremujorin e parë 2025; 5.3. Rregullorja për miratimin e projekteve dhe kërkesave të tjera - e miratuar në tremujorin e dytë të vitit 2025; 5.4. Rregullorja për të hyrat në Komplekset Memoriale - e miratuar	6,000.00€ (tre mijë euro)	Në pajtim të plotë me planin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe MKRS-ës

	memorialeve 5.6. Krijimi i simboleve për kujtimore për viktimat.			në tremujorin e dytë të vitit 2025; 5.5. Përshkrimi i vendeve të punës të miratuara dhe sistematizimi i vendeve të punës i finalizuar në tremujorin e dytë të vitit 2025;		
--	--	--	--	---	--	--

Imer Hakaj
Drejtor Ekzekutiv
Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve
dhe Komplekseve Memoriale

Njësia Përgjegjëse
MKRS

Shtojca Nr. 1

Emri i projektit	Buxheti 2024	Buxheti i planifikuar 2025	Buxheti i Planifikuar per 2026	Buxheti i planifikuar 2027	Totali 2025-2027
K.M “Adem Jashari” Prekaz - Skenderaj	2,000,000.00	3,000,000.00	2,000,000.00	2,000,000.00	7,000,000.00
K.M “Beteja e Koshares” Koshare	657,895.00	20,000.00	00	00	20,000.00
K.M “Masakra e Reçakut” Raçak	200,000.00	400,000.00	200,000.00	200,000.00	800,000.00
K.M “ZIV Shtabi i Përgjithshëm i UÇK - së Kleçkë dhe Divjakë” Malet e Berishës	300,000.00	250,000.00	50,000.00	50,000.00	350,000.00
Kompleksi i Varrezave “Dëshmorët e UÇK-së” Marinë – Skenderaj	100,000.00	50,000.00	00	00	50,000.00
Memoriali i Dëshmorëve të UÇK-së në Penuhë - Podujevë	100,000.00	20,000.00	00	00	20,000.00
K.M “Ibrahim Rugova”, Velani Prishtinë	50,000.00	100,000.00	100,000.00	100,000.00	300,000.00
K.M “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK - së ZOD Glllogjan”, Deçan	500,000.00	500,000.00	00	00	500,000.00
Projekti për intervenime Emergjente në K.M	300,000.00	400,000.00	200,000.00	100,000.00	700,000.00
K.M “27 Prilli” Meje, Gjakovë	20,000.00	150,000.00	00	00	150,000.00
K.M “Kulla e Demë Ahmeti” Podujevë	100,000.00	00	00	00	00
Rregullimi dhe mirëmbajtja e Sheshit “Adem Jashari”- Malishevë	100,000.00	00	00	00	00
Kulla e Heroit “Fehmi Lladrovci” - Gllanasellë, Drenas	100,000.00	100,000.00	80,000.00	00	180,000.00

Konservimi i shtëpisë ku është kryer Masakra në Poklek të Vjetër, Drenas	50,000.00	50,000.00	30,000.00	00	80,000.00
Ngritja e pllakës përkujtimore për daljen e parë të UÇK-së, Llaushë	35,350.00	00	00	00	00
Ndërtimi i Memorialit Shtabit” Kështjella 26” Halabak Podujevë	00	10,000.00	10,000.00	00	20,000.00
K.M Masakra e Krushës së Vogël, Prizren	5,000.00	5,000.00	00	00	5,000.00
Ngritja e Monumentit Madhor në Gurin e Gradinës, Bjeshkët e Berishës	50,000.00	50,000.00	00	00	50,000.00
Konservimi dhe Restaurimi i Disa Objekteve të Luftës së UÇK-së dhe Objektet ku Janë Kryer Masakrat	100,000.00	160,000.00	80,000.00	80,000.00	320,000.00
K M “Shtabi dhe Varrezat e Dëshmorëve të UÇK - së” Shqiponje Gjakovë	00	50,000.00	00	00	50,000.00
Memoriali i Masakrës së Verbovcit - Drenas	55,000.00	00	00	00	00
Rregullimi i Memorialit të Martireve ne Çikatovë te Re - Drenas	50,000.00	100,000.00	00	00	100,000.00
Vendosja e Pllakave Informuese ne Komplekse dhe Memoriale të Kosovës	150,000.00	160,000.00	50,000.00	50,000.00	260,000.00
Memoriali Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së, Tërstenik, Drenas	50,000.00	00	00	00	00
Memoriali “Eksodi i Bllacës 99” Hani i Elezit	10,000.00	70,000.00	00	00	70,000.00

Shtëpia Shtabi i UÇK - së” Zhegovc - Gjilan	40,000.00	50,000.00	00	00	50,000.00
Varrezat e Dëshmorëve në Suharekë;	50,000.00	00	00	00	50,000.00
Varrezat e Dëshmorëve në Grabanicë - Klinë;	100,000.00	100,000.00	00	00	100,000.00
Shtatorja e Rifat Mziut Skenderaj	50,000.00	10,000.00	00	00	10,000.00
Ngritja e Shtabit Ranzë - Shtime	00	50,000.00	00	00	50,000.00
Ndërtimi i Lapidarit të Dëshmorëve të UÇK - së - Mitrovicë	6,755.00	15,000.00	00	00	15,000.00
Memoriali i katër Dëshmorëve të Kaçanikut- Kaçanik	00	60,000.00	00	00	60,000.00
Ndërtimi i Memorialit të Dëshmorëve të Brigadës 136 Rugova në Pepaj- Rugovë - Pejë	60,000.00	60,000.00	00	00	60,000.00
Renovimi i varrezave të dëshmorëve në rajonin e Prishtinës, Mitrovicës, Gjilanit, Ferizajt , Prizrenit, Pejës dhe Gjakovës	00	300,000.00	50,000.00	50,000.00	400,000.00
Rregullimi i varrezave të dëshmorëve të UÇK- së në Viti dhe derdhja në bronzë e Busteve të Gursel dhe Bajram Sylejmanit - Sadovinë	00	10,000.00	00	00	10,000.00
Ndërtimi i parkut përkujtimor – Jabllanicë e Vogël - Pejë	00	10,000.00	00	00	10,000.00
Total:	5,390,000.00	6,310,000.00	2,850,000.00	2,630,000.00	11,790,000.00

Shtojca nr. 2

Mirëmbajtje:

Vitin 2024 Mirëmbajtja e Komplekseve Memoriale dhe parashikimet për vitin 2025, për mirëmbajtje dhe ruajtjen, si:

- Mirëmbajtja e K M “Adem Jashari” Prekaz – Skenderaj;
- Kompleksi Memorial “Masakra e Raçakut” Raçak – Shtime;
- Kompleksi i Varrezave “Dëshmorët e UÇK-së” Marinë – Skenderaj;
- Kompleksi “Kulla Zahir Pajaziti” Orllan Podujevë- Mirëmbajtja;
- Mirëmbajtja e Kompleksit Memoriali “Masakra e Likoshanit ‘- shtëpive të familjes Ahmeti – Drenas;
- Mirëmbajtja e Memorialit të Dëshmorëve të UÇK-së në Penuhë- Podujevë;
- Kompleksi Memorial “Dëshmorët e Kombit” Vrellë – Istog;
- Mirëmbajtja e Kompleksit Baza e Parë e UÇK-së, Llladovc Podujevë dhe Pestovë - Vushtrri;
- Mirëmbajtja e Kompleksit të varrezave të dëshmorëve të brigadës 121 të UÇK-së, Ismet Jashari – Kumanova, Kleçkë –Divjakë, Lipjan;
- Mirëmbajtja Memorialeve; Izbicë, Likovc, Likoshan, Rrezallë;
- Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmoreve në Dyz dhe Kaçanoll – Podujevë;
- Mirëmbajtja e Kompleksit Memorial “27 Prilli” Mejë , Gjakovë;
- Mirëmbajtja e Varrezave në K M të dëshmorëve të UÇK – së Malishevë;
- Mirëmbajtja e “Monumentit – Piramidës“ në Qirez – Skenderaj;
- Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve – Nëgrovc – Drenas;
- Mirëmbajtja e K M Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së në Viti dhe e Bustëve të Gursel e Bajram Sylejmanit – Sadovinë;
- Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve dhe Martirëve në Komunën e Drenasit Çikatovë të Vjetër, Poklek i Vjetër në dy Memoriale, – Drenas;

- Mirëmbajtja e Memorialit "Masakra e Familjes Deliu dhe Mulliqi dhe Varrezat e Dëshmorëve" në Abri të Epërme – Drenas;
- Memoriali "Eksodi- Bllaca 99" Hani i Elezit.
- Mirëmbajtja e lapidarit të Dëshmorëve Elfetë e Mentor Humolli – Lupç – Podujevë
- Mirëmbajtja e Memorialit të Martirëve – Vërbovc – Drenas
- Mirëmbajtja e Memorialit të Dëshmorëve dhe Martirëve në Shtuticë – Drenas
- Mirëmbajtja e Lapidarit të Dëshmorëve në Istog
- Mirëmbajtja e Memorialit Ibrahim Rugova – Istog
- Mirëmbajtja e lapidarit të Masakres se familjes Lipaj dhe Zeqiraj – Studenicë- Istog
- Mirëmbajtja e memorialit të Dëshmorëve dhe Martirëve në Komoran – Drenas
- Mirëmbajtja e Shtëpisë së Masakrës në Poklek të Vjetër – Drenas
- Mirëmbajtja e Memorialit të Martirëve të Masakrës se Poklekut – Poklek i Vjetër – Drenas
- Mirëmbajtja e Memorialit të Dëshmorëve në Abri të Epërme – Drenas
- Mirëmbajtja e Memorialit në Mramor
- Mirëmbajtja e varrezave të Dëshmorëve në Sllovi – Komuna e Lipjanit

Mirëmbajtjet e Komplekseve dhe Memorialeve të planifikuara për vitin 2025

- Varrezat e Dëshmorëve dhe Martirëve në Komunën e Drenasit-II-: Vasileva, Çikatova e Re, Pokleku i Ri, Krajkova, Llapushniku, Arllati, Gllanasella;
- Mirëmbajtja e varrezave të Dëshmorëve në Komunën e Klinës - Grabanicë – Klinë
- Mirëmbajtja e K.M Varrezat e Dëshmorëve Jabllanicë – Gjakovë
- Mirëmbajtja e Memorialit të Tre Dëshmorëve Uçë – Istog
- Mirëmbajtja e Shtatorëve
- Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve në Komunën e Kaqanikut
- Mirëmbajtja e Memorialit dhe Varrezave të Dëshmorëve në Tërnavc – Skenderaj
- Mirëmbajtja e Lapidarit të Dëshmorëve në Orroberdë
- Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve në Komunën e Kamenicës
- Mirëmbajtja e K.M të Dëshmorëve në Smolicë – Komuna e Gjakovës
- Mirëmbajtja e Varrezave të Dëshmorëve në Gllanasellë – Komuna e Drenasit

- Kompleksi Memorial “Masakra e Krushës së Madhe” –Krushë e Madhe, Rahovec;
- Kompleksi memorial në Krushë të Vogël- Krushë e Vogël, Prizren;
- Memoriali “Dëshmorët e UÇK-së” Xërxë Rahovec;
- Memoriali “ Varrezat e Martirëve” - Çabrat, Gjakovë;
- Memorialet në Komunën e Pejës;
- Memorialet në Komunën e Klinës;
- Memorialet në Komunën e Istogut;

Shtojca 3. Komplekset Memoriale, pronat e të cilëve duhet te shpronësohen gjate vitit 2025

Kompleksi Memorial	Zona Kadastrale	Komuna	Dorëzuar Elaboratin në MMPHI për procedim të mëtejme
“Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës”, Shtëpia dhe Bunkeri i “Radio Kosova e Lirë;	Berishë	Malishevë	PO
“Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së- Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës, Shtabi i Përgjithshëm, Spitalet e UÇK-së, Qendra protokollare;	Zona Kadastrale Divjakë	Lipjan	PO
Shtabi i Brigades 121, Pushimorja e Fëmijëve dhe	Kleçkë	Lipjan	PO
Fshati i UÇK-së; Mbetën për shpronësim në fazën e dytë.	Kleçkë	Lipjan	PO Por nuk do të shpronësohen
Shtëpia e Delegacionit të Rambujesë - Qeveria e Përkohshme në Novosellë, Mbetën për shpronësim në fazën e dytë.	Tërpezë	Malishevë	PO Por nuk do të shpronësohen
Mulliri i UÇK-së Mbetën për shpronësim në fazën e dytë.	Shalë (ish Sadllari)	Lipjan	PO Por nuk do të shpronësohen
Shtabi i “Komandant Kumanova”.	Luzhnicë	Suharekë	PO
“Masakra e Likoshanit”	Likoshan	Drenas	PO
“Dëshmorët e Kombit”	Vrellë	Istog	PO
Shtëpia ku është kryer Masakra në Poklek të Vjetër- Drenas	Poklek i Vjetër	Drenas	PO
KM “Masakra e Raçakut Raçak Shtime, Shtëpitë ku janë kryer masakrat, Janë ne proces të pagesave të shpronësimit;	Raçak	Shtime	PO Është nxjerrë vendimi Final Nr. 13/226 te datë: 23.10.2024. Pagesat një pjesë e shpronësimit kryhet këtë vit 2024 dhe pjesa tjetër do te kryhen vitin 2025.

K.M “ Shtabi i ZOD Gllogjan”, Deçan;	Gllogjan	Deçan	PO
Konservimi dhe restaurimi i shtëpisë ku është kryer masakra e familjes Lipaj dhe Zeqiraj;	Studenicë	Istog	Jo
Vlera e Përgjithshme e Shpronësimeve		3,620,000.00€	
Memoriali “Kulla e Demë Ahmetit “ Reçicë - Podujevë	Reçicë	Podujevë	Qeveria ka nxjerrë vendimin final për shpronësim, Vendimi Nr.08/101 Date:02.05.2019 Nga DSh - MMPHI kemi pranuar konfirmimin se mjetet për shpronësimin e këtyre pronave gjinden ne Fondin e Mirëbesimit në BQK, presim te reflektojnë pronarët, ose ne

Përfundimi i procedurës së shpronësimit është i domosdoshëm për fillimin dhe vazhdimin e projekteve. Pa u përfunduar shpronësimi, nuk ka mundësi të vazhdohet me punimet e mëtejme në ngritjen e këtyre Komplekseve Memoriale.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Shpronësimit për sigurimin e mjeteve, ne si institucion kemi dërguar elaboratet e shpronësimit në Departamentin e Shpronësimit në MMPHI, dhe presim që të na realizohen këto kërkesa.

Prandaj, për t'i realizuar tërë objektivat duhet të bëhet ndarja e buxhetit të mjaftueshëm, sipas parashikimeve tona.